



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 32

Datë: 19. 06. 2017, ora: 16:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.
Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi. Përkthyes: Vera Dula

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së
2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)
3. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Para se të fillojmë takimin, kisha dashur me iu drejtuar medieve dhe e kisha një kërkesë. Së pari, kisha dashur ta bëj një sqarim dhe të iu jap përgjigje, pasi kohëve të fundit kemi pasur shumë pyetje, nga gazetarët dhe qytetarët, se kur do të shpallën rezultatet përfundimtare dhe se kush janë deputetët e rinjtë të cilët do të certifikohen. KQZ akoma nuk ka shpallur rezultatet përfundimtare. Akoma nuk jemi në proces të certifikimit të tyre, pasi kjo do të bëhet vetëm pasi që të përfundohen rinumërimet të kutive të votimit, pas rinumërimit të votave me kusht, votave që kanë ardhur përmes postës dhe votave të personave me nevoja të veçanta. Gjithashtu edhe pas përfundimit të gjitha procedurave ligjore në QNR. Ne jemi duke punuar maksimalisht që këtë proces ta përmbyllim sa më shpejtë që është e mundur. Pra, këto ditë kanë qarkulluar nëpër media lista të ndryshme të deputetëve, të emrave. Këto janë vetëm ato të cilat janë publikuar nga mediet, jo nga KQZ. Atëherë kur publikohen nga KQZ-ja me siguri që do t'i keni. Faleminderit për mirëkuptim! Atëherë mundemi me filluar me takim. E hapi takimin e 32 të KQZ-së, me rendin e ditës ashtu

siç e keni para vetës. A kemi ndonjë pikë shtesë, apo ndonjë vërejtje? Nëse jo, kush është për këtë rend dite? Faleminderit!

2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

Valdete Daka: Kemi raportin nga QNR. Urdhëro, Burim!

Burim Ahmetaj: Të nderuar anëtarë të KQZ-së, faleminderit! QNR ka përmbyllur procesin e rinumërimit të 115 vendvotimeve të cilat nuk kanë mundur të kalojnë auditivin për shkak të parregullsive. Rinumërimi është kompletuar sot dhe materiali nga këto vendvotimi tashmë është duke iu nënshkruar procedurës së zakonshme të procedimit të formularëve të rezultateve, në mënyrë që t'i kemi rezultatet përfundimtare nga këto vendvotime të rinumëruara. Pra, QNR ka siguruar edhe listën e plotë. Raporti është i orës 12, tanimë jemi në orën 16:00, kështu që e keni para jush i vendvotimeve të rinumëruara i referohet orës 12, që ka qenë në proces. Tani procesin e kemi të kompletuar. Ndërsa në pjesën e procedimit, përkatësisht në futjen e të dhënave në formularët e rezultateve. Një numër i madh i formularëve të rezultateve nuk kanë mundur të kalojnë auditivin. Rast i njëjtë sikurse vendvotimet të cilat kanë qenë, 115 vendvotime nga auditivi që iu nënshtruan edhe rinumërimit. Arsyet thuhet janë të njëjta. Kemi raste kur subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota. QNR në disa raste iu ka referuar edhe fetave të punës, aty ku ka qenë e arsyetuar dhe ka mundur me korrigjuar disa raste i ka përmirësuar, aty ku nuk ka mundur me i korrigjuar i ka sjellë te ju, që figuron edhe në raportin e auditivit. Po ashtu raste tjera janë kur kandidatët e subjektit kanë më shumë vota sesa vet subjekti, dhe rasti bukur i shprehur është rast që një kandidat ka më shumë vota se subjekti. QNR i ka përgatitur po ashtu 3 kategori. Kategorinë si herën e fundit që ka qenë ku ndryshimi i votave, por mospërputhja e votave më shumë të dy apo më shumë subjekteve dhe 3 subjekte.

Tani, tha z. Ahmetaj, kemi bë një kategori që mospërputhja është të 2 apo më shumë subjekte. Kjo sa i përket ndryshimit të kategorive. Nëse i referoheni listës së procedimit të dhënave, e keni edhe tabelën e cila tregon procesin dhe progresin e punës në QNR, aty ku listat përfundimtare të votuesve janë 99.60% është proceduar lista përfundimtare e votuesve dhe jemi afër kompletimit të këtij procesi. Formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve janë 96.67% të proceduar në bazën e të dhënave. Formularët e rezultateve të kandidatëve 83.33%. nga ky 83.33% kemi një numër të formularëve të rezultateve të kandidatëve të cilët nuk mund të kalojnë auditivin për shkak të tejkalimit të votave kur kandidati ka më shumë vota. E keni edhe tabelën e cila është me 280 vendvotime nuk kanë mundur ta kalojnë auditivin. Akoma QNR nuk i ka të kompletuara të gjitha proceset. Ndoshta mund të dal ndonjë vendvotim tjetër që ndoshta mund të pritet vendim i KQZ-së, mirëpo këtu është pjesa më e madhe e të gjitha vendvotimeve për të cilat nevojitet vendim i KQZ-së. Nëse e shihni tabelën, ato të hijezuara janë ato raste kur, shembull në tabelë tek numri rendor 1 është që subjekti ka 33, ndërsa kandidatët kanë 0 vota. Pra, nuk është dokumentuar askund në formularët e rezultateve, për këtë arsye po të kishte një dokumentim të formularëve të rezultateve, sidomos të rezultateve të kandidatëve, ndoshta QNR do ta kishte marrë parasysh, mirëpo raste kur nuk ka të dokumentuara asgjë, sigurisht që nevojitet vendim i KQZ-së. I kemi bërë një kategorizim të vendvotimeve me mospërputhjen apo diferencën që

mund të dalloj nga vendvotimi i parë deri te vendvotimi i fundit. Kategoria e parë është për diferencë pra, tejkalimi i votave në vendvotimet të cilat kanë diferencën apo tejkalimin prej 1 vote deri në 10 vota dhe i referohet rekomandimit nga kategoria një ku mos përputhja e votave të kandidatëve të një subjekti, përgjithmonë i referohemi vetëm një subjekti ku diferenca nuk kalon mbi 10 vota por rekomandimi është që këto votat vetëm për këtë subjekt të rinumërohen ndërsa në këto raste ku vërehen mos përputhen ndoshta kërkohet edhe leja e KQZ-ës për tu rinumëruar të gjitha. Ndërsa për vendvotimet ku diferenca është më e madhe se sa edhe vota për të gjitha kategoritë rekomandimi është që të rinumërohen. Si do qoftë pasqyrën e keni të plotë me 280 vendvotime për të cilat nevojiten vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa këto të hijezuarat kanë të bëjnë me formularët e përputhjes të dhënave dhe rezultateve ku tek subjektet nuk figurojnë votat, ndërsa të kandidatët figurojnë vota. Mirëpo thash edhe njëherë as ne fletën e punës askund nuk shihet që këto vota subjekti i ka pra, nuk i kanë shënuar askund kështu që për këtë arsye ndoshta edhe kërkohet vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që këto vendvotime të rinumërohen për arsye se nuk kemi askund faktuar edhe pse kandidatët kanë vota pra, subjekti nuk ka vota të faktuara. Pra kjo është një mënyrë përmbledhëse e raportit mbi këto 280 vendvotime dhe kjo është gjendja nga auditivi të cilat vendvotime nuk kanë mundur ta kalojnë auditivin për shkak të mospërputhjes brenda për brenda formularëve të rezultateve, sidomos të rezultateve të kandidatëve .

Valdete Daka: Po urdhëro Betim...!

Betim Gjoshi: Unë kam dy qeshje me i diskutuar. E para, kam me diskutuar çështje shumë parimore ne jemi mundu si Komision Qendror Zgjedhor ti vëmë në dijeni Këshillat e vendvotimit që të kenë kujdes në numërimin edhe në gjithë procesin zgjedhor. Po shihet që edhe në këtë vit te procesi i numërimit të votave për kandidatë po në disa raste edhe për subjekte kemi pas probleme herë matematikore herë njerëzore po ndoshta ndonjë rast edhe të qëllimshëm për këtë mbetje pas rinumërimit me pa por, po e shohim që edhe 145 vendvotime i kemi marr mi numëruar i kemi edhe sot 210 që janë total i bije që kemi edhe 425 vendvotime . Unë kur kam par këtë numër të madh jam kujdesur që të shoh se si ka vajtur implementimi i masave që ka marr Komisioni Qendror Zgjedhor edhe kanë qenë pjesërisht të zbatueshme .Pllakati që kemi marr vendim me vendos nëpër vendvotime në pjesën më të madhe ka qenë i ngjitur por nuk ka qenë i përgatitur ashtu siç kemi kërkuar Komisioni Qendror Zgjedhor por, ka vazhduar sekretariati me kryer procesin e vet edhe e ka dërguar në formatin që ka menduar vet. Pastaj trajnimi që kemi vendosur të premtën që janë për këtë temë nuk është mbajtur fare edhe ju gjithë Këshillat e vendvotimit e kanë marr deklaratën edhe e ka nënshkruar atë, dëshmon edhe nga rinumërimi që po ndodh në qendrën e numërimit. Pra, edhe nuk janë të vetmet arsye këto që ka ndodh kjo por, po shihet që vendimet e Komisionit Qendror Zgjedhor nuk po gjejnë mbështetje aq sa duhet edhe nuk kanë pasur implementim duhet edhe për këtë në ditët në vazhdim të kërkoj që të shikohet edhe të merren veprime konkrete nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ajo çka më intereson mua në këtë fazë është sa i përket raportit burim ne kemi marr vendim që nja 115 kuti sa po shihet i keni numëruar 94, 21 prej tyre i kemi zgjidh pa i numëruar.

Ndoshta, vlerësoi z. Gjoshi, kish qen mirë me na tregu se si i keni zgjidh pak më të detajuar tu e pa me një fjalë që auditivi ka zgjidh por, na u kanë sjell mu numëruar kur kanë mundur mi zgjidh herën e parë. Për këtë nuk po e kërkoj për sot se nuk jam merak në përgjigje improvizuese por, ndoshta me një takim të radhës, e dyta sa i përket listës që na ke sjell vendvotimi i

fundit numër 280 nuk i takon asaj kategorie i takon kategorisë më përpara, kategorisë së dytë dhe e fundit që desha të them rreth kësaj është që e keni nda kategorinë e parë që është më e madhja prej 225 vendotimeve në dy pjesë edhe keni thënë që një pjesë numërohen total një pjesë por, nuk na keni nda me numër. Unë u mundova me i numëruar kështu manualisht 45 dolëm që duhet mi numëruar ndërsa 180 janë numëruar veç një subjekt politik, unë me tregu drejt qëndroj pas parimit që një Këshill i vendvotimit çka mund të gaboje te një subjekt ose një kandidat mund të gaboje te të gjithë me vazhduar me vendimin që kanë pasur herën e kaluar. Mund ti kërkojmë ndjesë publikut që ndoshta po na merr kohë më shumë por, ju sugjeroj që me vazhduar me punën edhe me pas mundësi me riorganizuar ndoshta me ndërrime, që një ndërrim të paktën mi numëruar dy kuti d.m.th ndoshta me zgjat orarin ose mi bo tri ndërrime me nga 5 orë apo sa po zgjat numërimi i një kutisë edhe me vazhduar me numërimin që edhe at mund të jenë më të qetë gjatë numërimit në qoftëse punojnë veç 5 orë, mund të na kushtoj pak më shumë materialisht por, mundemi rezultatet mi dhënë sa më shpejt për parti politike. Se ne jemi si Komision Qendror Zgjedhor jemi të detyruar që me ju dhënë rezultatet e sakta edhe me jap sa ma shpejt që është e mundur pa e cenuar sasinë e tyre. Unë në përgjithësi janë i kënaqur me pjesën tjetër të mbarëvajtjes të punës por, te kjo pjesë e përkrahi edhe më tutje me vazhduar me numërimin e plot të këtyre 280 kutive. Ju faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit Betim. Po na del që prapë jemi peng i komisionerëve fatkeqësisht. Po urdhëro.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Edhe unë e përkrahi propozimin e Betimit që të shkoj në numërim të plotë të këtyre kutive sepse mos barazimeve të subjekteve pavarësisht nuk po flasim për një subjekt po të gjitha subjektet po e shoh që janë në elementet që nuk ju përputhen brenda subjektit të kandidateve votat sa këtu mos barazime të votave deri në 100 e sa vota e mund të them që kandidatët e fundit që hynë në listë mund të jenë me vota deri në 10 vota diferencë prandaj jam që të rinumërohen te plotat kutitë që të ketë një proces ma të saktë edhe tjetrën e përkrahi po ashtu edhe deklaratën e kryetares gjatë publikimit të listës neper portale , nëpër gazeta të kandidateve të mundshëm që janë shpesh herë na sjellin më vonë probleme në KQZ-së në kuptimin se ka dalë nëpër portale thotë kandidati jam zgjedh deputet prandaj është mirë të kursehen edhe media mos të i qesin sepse fund të fundit KQZ-ja do të certifikojnë edhe subjektet , votat për subjekte dhe për kandidat

Adnan Rustemi: Faleminderit Burimit për këto informacione në radhë të parë sa i përket numrit të kutive që po i dërgojmë në rinumërim me gjithë se ka një ulje në krahasim me zgjedhjet e kaluara të paktën nga shifrat që i kemi deri më tani në dispozicion është e qartë që ky aspekti edhe i trajnimit të komisionarëve por edhe i shikimit të formave të rezultateve do të përputhjeve do të rishikohen vazhdimisht se është ngritur si çështje por për fat të keq nuk e ka gjetur një herë përgjigjen për tu thjeshtuar dhe për tu bërë ma i lehtë edhe për komisionarët që mos të bëhen gabime të tilla, natyrisht që unë pres që sot burimi me na dhënë të paktën një përgjigjen të përgjithshme pse i kemi vetëm 94 vendotime në raportin për vendimin e paraprakë të KQZ-së për 114 kuti që i kemi dërguar në rinumërim sikurse kam edhe një kërkesë prej Burimit prej QNR-ës në këtë rast e thotë aty edhe në dokument që QNR-ja do të bëjë si me thënë ruajtjen e gjendjes aktuale të futjes të dhënave nga FPR-ët e kam fjalën për rezultatet për subjektet politike sepse si rezultat i numërimeve do të ketë tërheqje do të thojë të formularëve të dhënave të futura për tu përfshirë më pas formularët përfundimtar nga rinumërimi. E keni thënë edhe në arsyetim që bëhet për të analizuar

dallimet eventuale për anëtarët e KQZ-ës për mua personalisht kish qenë me interes me pa këtë raport të krahasimit midis rezultateve për subjekte politike po flas jo për kandidatë në mes të FPR-ve para rinumërimeve dhe FPR-ve pas rinumërimeve ta shohim gjendjen se a ka pasur ndryshime a jo edhe a bëhet fjalë për gabime teknike e matematikore apo për dallime tjera.

Tjera, sa i përket rekomandimit të sotëm është e vërtetë që është një numër mjaft i madh i kutive dhe nëse e shohim dinamikën e rinumërimit të 115 kutive shihet qartë që do të merr kohë rinumërimi respektivisht shpallja e rezultateve përfundimtare dhe certifikimi i tyre në fund unë nuk jam kundër rinumërimit të përgjithshëm edhe për kategorinë e parë, sa do që jam për një vendim që i respekton rekomandimet e QNR-ës në këtë rast për të fituar në kohë që kemi rezultate edhe proces sa më shpejt të mbyllur që së paku kategorinë e parë që bëhet fjalë për dallimet me nga një deri në dhjetë vota për kandidatët e të njëjtit subjekt politik jo më tepër d.m.th e që në këtë rast janë të paktën nga ky raport diku 150 kuti, kish qenë mirë me u numëruar veç votat e atij subjekti politik. Nuk është që është vetëm një subjekt politik këtu janë thujse të gjitha ose shumica të përfshira por, për sa kohë bëhet fjalë vetëm për një subjekt politik mendoj që fitojmë shumë në kohë. Unë e kam parë procesin e rinumërimit nëse i referohen vetëm votave të subjektit përkatës në këtë rast shumë më shpejt do ta kemi procesin ndërkohë për tjerat jam që të numërohen në tërësi dhe që të kemi raporte përfundimtare dhe është mirë që të vlerësohet nga sekretariati jo vetëm nga QNR-ja mundësia për rritjen e kapacitetit edhe për një menaxhim adekuat dhe efikas të resurseve qoftes edhe mbi këtë bazën që u tha që ekipi të jetë i përqendruar vetëm për një kuti dhe të mos të konsiderohet nga ekipi i numërimit në këtë rast që komplet ndërrimi është në surbim të rinumërimit të vetëm një kutie sepse e dimë që ka raste kur dy orë pa përfunduar ndërrimi përfundon rinumërimi i një kutie dhe bëhet i pamundur fillimi i kutive së radhës nga i njëjti ndërrim për sa kohë duhet ta lenë në gjysmë me tu dëmtuar nga ndërrimi tjetër d.m.th është mirë me shqyrtuar këtë e rrit efikasitetin d.m.th edhe përmbillet më shpejt. Megjithatë jam për rekomandimet që i dha QNR-ja.

Valdete Daka: Faleminderit. Po urdhëro.

Binak Vishaj: Faleminderit. Unë kish kërkuar nga Burimit, sot është e pamundur po na tha që veç ka përfunduar rinumërimi i këtyre 115 kutive dhe na jepet një raport një pasqyrë e FPR-ve se si kanë qenë para rinumërimit edhe tash pas rinumërimit të atij d.m.th në këtë pjesën si dhe të atyre 21 kutive që ishin sjell për rinumërim ndërsa tash auditimi i ka qit si të rregullta d.m.th na jep tjetër arsye. Pra, edhe unë qëndroj pas asaj që është mirë ti përmbahemi rekomandimeve të QNR-ës për këtë pjesën ku dallimi në votë është një deri në dhjetë vota që të numërohen vetëm votat për subjektin politik mendoj që e shpejton procesin e numërimit edhe na duhet me pak kohë që ne të vijmë në rezultatet preliminare. D.m.th ti përmbahen këtij rekomanduar tuaj, sa i përket këtyre kutive që kanë të bëjnë vetëm me dallim vetëm një votues.

Eshref Vishi: Faleminderit kryetare, përshëndet je për të gjithë. Është fakt që Këshillat e vendvotimeve janë përgjegjëse për sigurimin e integritetit të procesit të votimit dhe të numërimit të votave në vendvotim në mbikëqyrjen Komisionit Komunal Zgjedhor. Mirëpo me gjithat kjo çështje e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që do të del në analizë të tërë procesit zgjedhor dhe më pas merremi edhe me këtë çështje për arsye se kemi mbi 400 kuti të cilat po hyjnë në procesin e rinumërimit në qendrën e numërimit dhe rezultateve. Parimisht jam edhe për ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor, por edhe për përshpejtimin e punëve

dhe aktiviteve të qendrës së numërimit të rezultateve, në mënyrë që të lëvizim më shpejtë drejt publikimit të rezultateve dhe përfundimin e procesit zgjedhor. Raporti i koordinorit të QNR-së është i qartë. Sa i përket rekomandimeve mendoj që duhet të mbështetet dhe unë jam për atë që, kur është fjala për numërimin e votave për një subjekt politik, duke marrë parasysh kohën që të përshpejtojmë drejt publikimit të rezultateve, të lëvizim me rekomandimet që i dha koordinatori. Sado që mu nuk më pengojnë dy propozimet që janë këtu. Edhe propozimi i QNR-së, por edhe propozimi i kolegeve. Kam dhe një kërkesë për koordinorët të qendrës numërimit të rezultateve që si pjesë e raportit po vije edhe aktivitetet që janë zhvilluar deri më tani në QNR-ë, mirëpo edhe raporti i auditimit me rekomandime është mirë që edhe kjo të na vij si dy dokumente ndaras të mos jetë pjesë e një raporti d.m.th dy pjesët. Faleminderit.

Valdete Daka: Faleminderit kryeshef.

Betim Gjoshi: E para, unë nuk besoj që kemi ndonjë nguti, brenda planit operacional mendoj që jemi në rregull. E dyta, nuk besoj që është ndonjë nguti kështu, unë e di që me pas mundësi rezultatet i kishim nxjerr atë ditë që kanë përfunduar zgjedhjet, po ne edhe kemi nxjerr rezultat preliminar i cili shumicën nuk na ndryshon as me 0 presje dhjetore. E treta, për me marr një vendim kështu që mos mi numëruar këto ndoshta ka qenë mirë mi bo nja dy tri vendvotime ku kanë qenë në rekomandimin e parë që të numërohen prej subjekteve vetëm që të shohim a ka pasur dallime te subjektet tjera. Edhe besoj që është dashur kështu të veprojmë QNR-ja. Ne mundemi çfarëdo vendimi me marr sot, po këta është mirë me pa vet punën se ka qenë gjendja se nuk kemi nevojë, unë në mes saktësisë së votës edhe kohës jam për saktësinë e votës, jam për me dërguar vullnetin e qytetarëve e mos me lejuar vullnetin e komisionarëve. Të ju them të drejtën çfarëdo vendimi dhe çfarëdo rekomandimi nuk është ndonjë problem se unë nuk ndahem nga kolegët në punën e votës. Por, unë mendoj që QNR-ja para rekomandimeve duhet të realizoj këto çështje. Por duhet me pa cili ka qenë dallimi kur e ka hap kutin, cili ka qenë? Ka qenë dallimi të ajo një votë e një kandidati, apo ka qenë dallimi të të gjitha subjektet politike. Se unë thash edhe njëherë unë gabimin njerëzor e pranoj për mua janë krejt normale, kanë qenë njerëz të lodhur janë për mi pas parasysh por, nëse ka ndodh ndonjë situatë tjetër brenda kutisë atëherë në gjithësesi që duhet ti rinumërojmë ato.

Ne, tha Gjoshi, të gjithë po e dimë si e kemi gjendjen me kandidat. Unë për veti personalisht si anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor nuk mund të garantoj asnjë kandidat për votat e sakta sa i përket kësaj. Ky sistem d.m.th ka probleme të ndjeshme sa i përket kandidatëve edhe tri me numëruar edhe njerëzit profesionist e kanë vështirë me ja qëlluar votat e njëjta por, edhe këtë e kuptoj sepse ka të bëjë me një kuti që i ka 400 vota here 5 dy mijë vetëve me i numëruar nuk është e lehtë për njerëz që janë kanë filluar punën në 6 të mëngjesit edhe kanë punuar deri në mëngjes. Por jam për me i ndalu ata që kanë bërë qëllimshëm. Por jam për me ndalu ata që me pas deputet të komisionarëve, thjesht kjo është ajo kërkesa ime për mua vazhdojmë se po e shoh se shumica jeni me shikuar, ta shikojnë këtë d.m.th të shikojnë katër mostra që ditën e parë i kanë sjell si rekomandime për ti numëruar vetëm për një subjekt i shohin si kanë dal kandidatët subjektet tjera. Nuk dua të paragjykoj, këta le ta vendosin, ne mund të ju japin një aprovim me filluar me rinumërimin në bazë të gjendjes që kanë pasur me kutit e kaluara. Ju faleminderit.

Sami Hamiti: Kryetare unë megjithatë jam që të numërohen, andaj nuk do të jem për rekomandimin e koordinorit të QNR-së. Jam që të numërohen të gjitha.

Valdete Daka: Faleminderit, atëherë unë e dërgoj në votim rekomandimin e koordinatorit ajo është që të rinumërohen vetëm votat e kandidatëve për atë subjekt, kush është për, kush është kundër, kush abstenon, atëherë me shumicë të votave, u aprovuar rekomandimi i koordinatorit. Vazhdojmë me rekomandimin e dyte që është mos përputhja e kandidateve nga një subjekt ku diferenca kalon mbi 10 vota, këtu është dhënë rekomandimi që të rinumërohen te gjitha vendvotimet, i gjithë vendvotimi pra jo vetëm ato, kush është për këtë rekomandim, faleminderit. Rekomandimi i 3 është në të vërtet i 2 sepse këto ishin nën A dhe nën B, është që edhe këto vendvotime ku ka pas mos përputhje të votave të dy kandidatëve a ma shumë subjekteve te rinumërohen i gjithë vendvotimi, kush është për këtë, faleminderit. Kategoria e 3-te, apo rekomandimi i 3-te është ku kemi pas mospërputhje në formular të rezultateve që edhe këto vendvotime të rinumërohen kush është për, pra i kemi pas 4 rekomandime. Burim faleminderit.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
